



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.12.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. Mbylljet rasti me Nr. APK-DPKI-06-752/24, për zyrtarin e lartë z. Qamil Stagova, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes se Mjedisit, Komuna e Kaçanikut, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
 - II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit.

A r s y e t i m

- I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interes i në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Qamil Stagova, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/1-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ajencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë:

“[...] Shumicë e tenderëve ne Komunën e Kaçanikut, i merr një i afërm i z. Qamil Stagova prej se është emëruar si Drejtor i Urbanizimit”[...]

Sipas procedurës pasi ka analizuar informatën e pranuar, Agjencia për Parandalimin e Korruptionit përmes shkresës zyrtare DPKI-06-752/24, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Qamil Stagova, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtura një takim në zyrat e Agjencisë, me ç' rast zyrtari në fjalë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit.

Në takimin e mbajtur në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Satgova ndër të tjera deklaron se: "sipas informatave qe aji i posedon kompania në fjalë apo operatori ekonomik ka pasur dhe ka kontrata të lidhura më Komunën e Kaçanikut, njehërit ka deklaruar se kjo kompani është në pronësi të familjareve të bashkëshortes se tij, si dhe ka sqaruar se të gjitha procedurat

janë zhvilluar nga zyra e Prokurimit, dhe në asnjë prej këtyre procedurave nuk ka pasur rol vlerësues apo vendimmarrës.

Nga informatat që përmban raportimi për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur me zyrtarin Qamil Stagova, si dhe informacioni/ dokumentacioni në dispozicion, Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar si në dispozitivin e këtij vendimi, duke marrë përbazë shqyrtimin e informacioneve në dispozicion si dhe shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se, në aktivitetin e prokurimit nr. 652-23-5552-5-2-1, si dhe në aktivitetin e prokurimit nr. 652-23-9763-2-2-1, zyrtari Qamil Stagova, në zyrën e prokurimit ka parashtuar kërkeshën për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit të lartcekura bashkangjitur paramasën dhe parallogarin, mirëpo gjatë procesit të tenderimit (vlerësim i ofertave, nënshkrimit i kontratës si dhe caktimi i menaxherit të kontratë), i njëjti nuk ka qenë i përfshirë në asnjë fazë të procesit të vendimmarrjes.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit*, për zyrtarin e lartë z. Qamil Stagova përkitazi me pretendimin e ngritura nga raportuesi i rastit se përmes ndikimit e tij, shumicën e tenderëve i merr i afërm i tij në Komunën e Kaçanikut, ku nga informacionet e siguruara është vërtetuar se kompania për të cilën është ngritur dyshimi nuk figuron të jetë pronar e personit të afërt me zyrtarin, pasi që pronari i kësaj kompanie nuk hynë ne kategorinë e personave të afërt sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në sqarim të kësaj situate Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka marr përbazë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ku është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrëthanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdekclarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

“Interesi privat i personit zyrtar - nënkuption çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërm, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënien afariste”,

si dhe me nën-paragrasin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

“person i afërm me zyrtarin është - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërm i një gjini të krushqisë deri në shkallën e dyte si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesit privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin.

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nacionin vendimmarrje si:

“Casti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilët vendoset përbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”

Situata e konfliktit të interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur ndonjë element përbajtjesor që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jetë plotësuar apo të ketë një nga *kushtet kumulative*, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes në çështjen konkrete.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bazuar ne dokumentacionin në dispozicion (*vendimin për formimin e komisionit të vlerësimit, anëtar i komisionit të vlerësimit, nënshkrimi i kontratës, si dhe vendimin mbi emërimin e menaxherit të kontratës*), konstaton se në kuptim të dispozitave të sipërcituara, z. Qamil Stagova, nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja nga zyrtari (*si kusht i domosdoshëm kumulativ*), si dhe mungesa e elementit të papajtueshmërisë sipas nenit 13 paragrafi 3, përjashtohet situata e konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit se zyrtari lartë z. Qamil Stagova, prej se është emëruar si Drejtor i Urbanizimit në Komune e Kaçanikut, përmes ndikimit të tij shumicën e tenderëve po i merr kompania e të afërmit të tij në Komunën e Kaçanikut, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, nuk ka gjetur se ka pasur ndonjë deklaratë me shkrim nga anëtaret e komisionit për tentim ushtrimi të ndikimit në vullnetin e tyre, në kuptim të nenit 16, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku përcaktohet se:

1. “Nëse ekziston tentimi i ndikimit në vullnetin e tij, zyrtari duhet ta lajmërojë me shkrim dhe të konsultohet me udhëheqësin apo institucionin udhëheqës të organit që e ka zgjedhur apo emëruar në mënyrë që të shëmang çdo ndikim në vullnetin e tij.”


2. “Nëse ndaj zyrtarit gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marrë vendim konkret zyrtari e njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrimit do të vendosë nëse ekziston një bazë e arsyeshme që të lajmërohen organet e ndjekjes.”

Ndërsa, lidhur me pretendimet tjera të raportuesit të rastit të cilat janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe rrjedhimisht jashtë kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk janë trajtuar gjatë kësaj procedure .

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë*”, si dhe paragrafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: “*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


Ylli BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)